



Zëri i qytetarëve në zgjedhjet lokale në Shqipëri 2015

Sashenka Lleshaj

Zëri i qytetarëve në zgjedhjet lokale në Shqipëri 2015

Tiranë 2015

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-te
Kutia Postare 1418
Tirane, Albania

Autore: Sashenka Lleshaj

Përkthyes: Dritan Sulcebe
Bora Prifti

Me mbështetjen e Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare (AIISS)

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Përmbajtje

Hyrje.....	5
Përmbledhje.....	7
Metodologjia.....	10
Karakteristikat e kampionit.....	10
Gjetjet dhe analiza.....	12
Zgjedhjet dhe përzgjedhja e kandidatëve.....	12
Informacioni dhe perceptimet mbi reformën e fundit administrative.....	18
Qeverisja Lokale dhe Shërbimet Publike.....	21

Hyrje

Periodhat parazgjedhore janë të mbushura zakonisht me sondazhe që synojnë parashikimin e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe të rezultateve. Këto anketa janë më shumë të interesuara në llogaritjet zgjedhore dhe dinamikat e qeverisjes pas zgjedhjeve sesa në perceptimet dhe kërkesat e qytetarëve, pëlqyeshmërinë ndaj punës së përfaqësuesve të tyre gjatë mandatit të fundit, ose nivelin e përgjithshëm të njohurive dhe informacioneve që ata kanë mbi hartimin e Kodit Zgjedhor dhe specifikat e veçanta të votimit dhe përfaqësimit të tyre. Ndërsa Shqipërisë i mungon një traditë të konkurrencës programore në zgjedhje, dhe ndërsa kandidatët janë shumë të varur nga mbështetja e tyre partiake dhe reputacioni personal, në mënyrë që të fitojnë garën elektorale, nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë injoruar ose marginalizuar vazhdimisht gjatë gjithë periudhës parazgjedhore dhe përtej. Ky studim është pjesë e një projekti më të gjerë që synon eksplorimin e pikëpamjeve të qytetarëve, nevojat dhe kërkesat gjatë periudhës parazgjedhore në mënyrë që të ndikojë në përcaktimin e axhendës së kandidatëve përpara se mandati i tyre të fillojë. Duke i paraqitur kandidatëve çështjet që konsiderohen të rëndësishme nga qytetarët, projekti synon lidhjen e përfaqësuesve lokalë me elektoratin e tyre nga fazat e hershme të fushatës, në mënyrë që programet e tyre politike të reflektojnë dhe t'i përgjigjen më mirë nevojave të komunitetit lokal. Kjo anketë përmban tri pjesë kryesore që synojnë matjen e perceptimeve, nivelin e informacionit në lidhje me çështjet e lidhura me zgjedhjet dhe nivelin e miratimit së qytetarëve ndaj shërbimeve publike të ofruara në bashkinë e tyre.¹

Pjesa e parë, **Zgjedhjet dhe përzgjedhja e kandidatëve**, përpiket që të pasqyrojë gatishmërinë e qytetarëve për të marrë pjesë në zgjedhje, pritshmëritë e tyre ndaj kandidatëve, si dhe për të vlerësuar njohuritë e shtetasve mbi procesin e përzgjedhjes së kandidatëve.

Pjesa e dytë, **Informacioni dhe perceptimet në lidhje me reformën e fundit administrative**, prek një komponent shumë të rëndësishëm të këtyre zgjedhjeve, që është reforma e re administrative, e cila ndikon në gjeografinë dhe konfigurimin e njësive zgjedhore. Ndërsa reforma u miratua në Kuvendin e Shqipërisë në fund të korrikut të vitit 2014, nuk ka qenë gjithmonë e qartë nëse qytetarët kanë qenë të informuar plotësisht në lidhje me ndryshimet që kjo reformë do të sillte në njësitë e tyre bashkiake. Prandaj është dyfishuar edhe konfuzioni në lidhje me zgjedhjet e ardhshme.

1 - Njësitë administrative të kësaj ankete janë konsideruar ato ekzistuese përpara zgjedhjeve dhe jo ato të zgjeruarat, të cilat do të krijohen me zbatimin e reformës territoriale administrative pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015.

Pjesa e tretë, **Qeveria lokale dhe shërbimet publike**, synojë të adresojë shkallën e miratimit të qytetarëve ndaj shërbimeve të ofruara në komunën e tyre dhe në atë që ata e konsiderojnë si të rëndësishme që të përmirësohet në të ardhmen. Pikërisht nga kjo pjesë e fundit mbi shkallën e miratimit të qytetarëve dhe përmirësimet e nevojshme, ky projekt do të ndërhyjë në përcaktimin e axhendës fillestare të kandidatëve në mandatet e tyre të ardhshme.

Përmbledhje

Periodhat parazgjedhore janë delikate në njërin anë dhe shumë të dobishme nga ana tjetër në lidhje me njohuritë që mund të përfitohen nga fotografimi i perceptimeve dhe pikëpamjeve të qytetarëve. Kjo anketë është kryer në periudhën para fushatës për të shmangur perceptimet shtrembëruara që mund të vijnë si pasojë e valëve kontradiktore të informacionit që fushata elektorale mund të reflektojnë mbi qytetarët. Megjithatë, ky studim ka kërkuar të ndajë disa pikëpamje të rëndësishme mbi perceptimet dhe shqetësimet që qytetarët kanë shprehur në prag të zgjedhjeve lokale të 2015.

Vullneti për të votuar dhe besimi në ndershmërinë e zgjedhjeve

Ndërsa një shumicë e madhe e të anketuarve raportojnë vullnetin e tyre për të votuar në zgjedhjet e ardhshme lokale, një pjesë e konsiderueshme më e vogël beson se zgjedhjet e ardhshme do të jenë të lira dhe të ndershme. Kështu, më shumë se 70% e të anketuarve në Tiranë, Durrës, Lezhë, Peshkopi dhe Pogradec raportuan se ata do të votojnë në zgjedhjet e ardhshme dhe më shumë se 80% e të anketuarve raportuan të njëjtën gjë në Berat dhe Korçë. Në anën tjetër, rreth 50% mendonin se këto zgjedhje do të jenë të lira dhe të ndershme në Berat dhe Korçë, ndërsa më pak se 50% mendonin kështu në Tiranë, Durrës dhe Peshkopi me më pak sa 36% në Lezhë dhe 27% në Pogradec të cilët mendonin se zgjedhjet do të jenë të lira dhe të ndershme. Rrjedhimisht, është e qartë se në përgjithësi, të paktën 1 në 4 të anketuar janë të gatshëm të votojnë në zgjedhjet e ardhshme, pavarësisht nga fakti se ai ose ajo beson se zgjedhjet do të jenë të lira dhe të ndershme.

Vendimet për votën dhe përzgjedhja e kandidatëve

Mbi çfarë baze vendosin qytetarët për të votuar kandidatët? Ndërsa kjo është një pyetje shumë e gjerë për t'u trajtuar në këtë anketë, ne kemi marrë disa njohuri mbi arsyet kryesore mbi vendimmarrjen e zgjedhësve. Edhe pse në një shkallë të thjeshtëzuar, ne kemi përdorur një përqasje Weberian-e në propozimin e kategorive të opsioneve dhe kështu kemi propozuar opsione të tilla si: personaliteti të kandidatit dhe cilësitë e tij, partia politike e kandidatit dhe programit të kandidatit.

Cilësitë personale të kandidatit ishin përgjithësisht opsioni më i përhapur në mesin e të anketuarve, ndërsa partia politike e kandidatëve ishte vetëm opsioni i tretë i zgjedhur. Ishte e habitshme gjatë konstatimit se të anketuarit e ishin më të prirur për zgjedhur treguar programin e kandidatit në krahasim me partinë e kandidatit, si një element përcaktues të votës së tyre.

Konfuzion mbi ata që përzgjedhin kandidatët e partisë për zgjedhje

Ndërsa shumica e të anketuarve mendojnë se kandidatët për kryetar të komunës zgjidhen ose nga kryetari i partisë ose nga kryesia qendrore të partisë, ka një konfuzion të qartë mbi individët apo strukturat e partisë që përzgjedhin kandidatët për këshillin bashkiak. Kështu rreth 80% e të anketuarve në të gjitha bashkitë ku janë zhvilluar intervistat, përveç Peshkopisë, u përgjigjën se përzgjedhja e kandidatëve për kryetar komune ishte një praktikë shumë e centralizuar, duke qenë e drejtuar nga qendra e partisë.

Në anën tjetër, gama e përgjigjeve në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për këshillin e bashkisë ndryshonte në varësi të liderit të partisë dhe qytetarëve të njësisë, ndërsa të anketuarit e shihnin këtë proces përzgjedhës si më të decentralizuar se ai për kryetarin e bashkisë.

Të pavendosur në lidhje me reformën administrative: disi të informuar dhe disi të lumtur.

Ndërsa reforma administrative territoriale e miratuar kohët e fundit, u diskutua për një kohë të gjatë, shumë prej anëve të saj teknike nuk janë ende të qarta për publikun, sidomos kur bëhet fjalë për organizimin e njësive të reja dhe menaxhimin e territorit të ri në periudhën pas-zgjedhore. Ky element ishte i qartë në studim, pasi shumica e të anketuarve u pozicionuan midis po dhe jo (disi ose shumë pak), kur u përgjigjën në lidhje me nivelin e informacionit mbi reformën administrative të miratuar kohët e fundit. I njëjti model është i dukshëm kur të anketuarit u pyetën nëse ata mendonin se reforma ishte e nevojshme dhe në qoftë se ata ishin të kënaqur me rezultatet e saj. Kështu, pjesa më e madhe e anketuarve në të dy rastet u përgjigj se reforma ishte disi e nevojshme dhe se ata ishin pjesërisht të lumtur me të.

Mbi shërbimet publike dhe nivelin e pëlqimit

Në përgjithësi, të anketuarit kanë tendencë që të pozicionohen në mes, kur pyeten për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve publike apo kënaqësinë e tyre me ta. Kjo ishte e dukshme gjatë anketës, edhe pse modele të veçanta mund të vërehen në lidhje me shërbime të ndryshme. Të pyetur në lidhje me kënaqësinë e tyre ndaj punës së pushtetit lokal gjatë katër viteve të fundit, në përgjithësi gati gjysma e të anketuarve u përgjigjën se ishin pjesërisht të lumtur. Megjithatë, gjysma tjetër është më shumë e pakënaqur sesa e kënaqur me punën e pushtetit lokal dhe ky trend është i pranishëm në të gjithë kampionin. Në të njëjtën kohë, të anketuarit që ishin përballur personalisht me bashkinë në ndonjë rast apo tjetër, raportohet të jenë më të pakënaqur sesa të kënaqur me zgjidhjen ose ndihmën e dhënë nga bashkia.

E njëjta tendencë ishte e pranishme kur të anketuarit treguan nivelin e tyre të kënaqësisë me një seri shërbimesh publike të listuara. Megjithëse, pjesa më e madhe e të anketuarve u pozicionuan në mes të spektrit të kënaqësisë, relativisht më shumë të anketuar treguan që ishin jo të kënaqur apo shumë të pakënaqur, sidomos në rastin e shërbimeve, si strehimi, planifikimi urban dhe shërbimet sociale.

Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me aktivitetet kulturore dhe turistike në bashkitë e përzgjedhura, të anketuarit ishin më të pakënaqur sesa të kënaqur. Në anën tjetër, të anketuarit ishin kryesisht të kënaqur ose kryesisht të pakënaqur me disa shërbime kur u pyetën specifikisht rreth tyre. Kështu, një shumicë e madhe e të anketuarve ishte e kënaqur ose deri diku e kënaqur me kushtet e shkollave dhe kopshteve në bashkitë e tyre. Kur u pyetën nëse ishte bërë punë e mjaftueshme është për zhvillimin ekonomik apo për mbrojtjen e mjedisit në komunën e tyre, një shumicë e madhe e të anketuarve u përgjigj negativisht.

Shqetësimet më të mëdha të Komunitetit


Kur bëhet fjalë për të treguar shqetësimet kryesore të çdo komuniteti, papunësia, varfëria dhe korrupsioni janë shqetësimet kryesore të paraqitura nga të anketuarit.

Metodologjia


Ky studim është kryer qëllimisht në mars 2015, për të qenë larg nga periudha e fushatës zgjedhore. Një total prej 1600 pyetësorëve janë administruar në 6 bashki: Berati (200), Lezha (200), Durrësi (200), Korça (200), Peshkopia (200), Pogradeci (200) Tirana (400). Intervistat janë zhvilluar vetëm në qytete, pra në bashkitë qendrore, dhe të anketuarit kanë qenë përzgjedhur rastësisht.

Karakteristikat e Kampionit


Për sa i përket gjinisë numri i të anketuarve meshkuj dhe femra ka qenë i ekuilibruar përgjatë intervistave. Kështu kampioni i kësaj ankete ishte i përbërë nga 51% femra dhe 49% meshkuj.




Në lidhje me moshën, pjesa më e madhe e kampionit (45%) është e përbërë nga njerëz që i përkasin grupmoshës 18-35 vjeç. Pjesa tjetër, 30%, i përket grupmoshës 36-50. Kështu, 75% e kampionit kishte një moshë të re duke qenë nën 50 vjeç. 21% e kampionit i përket grup-moshës 51-70 vjeç, ndërsa vetëm 4% e të anketuarve ishin mbi 70 vjeç.



Për sa i përket nivelit të arsimit, pjesa më e madhe e të anketuarve (48%) ka përfunduar një arsim të nivelit universitar, ose arsimin e lartë (37%) ose një master apo doktoraturë (11%). Grupi i dytë më i madh i të anketuarve është e përbërë nga ata që kanë përfunduar arsimin e shkollës së mesme (42%). Një pjesë më e vogël e të anketuarve u përgjigjën se kishin mbaruar shkollën fillore ose nuk kishin arsimim.




Në lidhje me punësimin, pjesa më e madhe të anketuarve ishte e punësuar (40%). Një pjesë e konsiderueshme (25%- pra 1 në 4 të anketuar) raportuan se ishin të papunë, ndërsa 18% ishin studentë. Dy pjesë më të vogla të kampionit përbëheshin nga pensionistë (11%) ose shtëpiake/shtëpiakë (5%).




Gjetjet dhe analiza

Zgjedhjet dhe përzgjedhja e kandidatëve


Kur u pyetën nëse kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit lokale (Maj 2011), shumica e të anketuarave (më shumë se 70%) u përgjigjën pozitivisht. Pjesëmarrja më e lartë në zgjedhje u raportua në Korçë me 9 nga 10 vetë (88%) që raportuan se kishin votuar në 2011, ndërsa më e ulëta u raportua në Pogradec, ku 6 nga 10 vetë (70%) kishin votuar. Nivelet e raportimit për pjesëmarrje në zgjedhje në Tiranë, Lezhë, Durrës, Berat dhe Peshkopi ishin midis këtyre dy vlerave.




Ndërsa rreth 8% e të anketuarave ishin të pavendosur nëse ata do të votojnë apo jo në zgjedhjet e ardhshme lokale të 21 qershorit, shumica prej tyre kanë raportuar se ata janë të gatshëm të marrin pjesë në zgjedhje. Pothuajse i njëjti numër i të anketuarave për qytet që raportuan pjesëmarrjen në zgjedhjet e kaluara, gjithashtu raportojnë gatishmërinë për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme. Megjithatë, ia vlen të theksohet se ka disa rritje statistikisht relevante të pjesës së njerëzve që ishin të gatshëm për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme krahasuar të anketuarit që kanë raportuar pjesëmarrjen në zgjedhjet e kaluara në Durrës (nga 70% në 76% e të anketuarave), në Peshkopi (nga 71% deri 77% e të anketuarave) dhe sidomos në Pogradec (nga 60% deri në 71% e të anketuarave).



Kur u pyetën për arsyet e vendimin e tyre për të bojkotuar zgjedhjet, përgjigjet e të anketuarve në qytetet ku u zhvillua anketa ndryshonin. Në fakt, shumica e njerëzve në Korçë (78%), Berat (64%) Lezhë (62%), Peshkopi (61%) dhe Pogradec (53%) janë përgjigjur se nuk do të votonin për shkak se ata nuk mendojnë se zgjedhjet do të sillnin ndonjë ndryshim. Në Tiranë, gjysma e të anketuarve nuk do të votonin për të njëjtën arsye, ndërsa pothuajse e njëjta pjesë (45%) mendonin se zgjedhjet e ardhshme nuk do të jenë të lira dhe të ndershme. Shumica e atyre që nuk do të votonin në Durrës (54%), gjithashtu u përgjigjën se ata nuk besonin që zgjedhjet do të jenë të lira dhe të ndershme. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve bojkotues në Peshkopi (36%) ishin gjithashtu mosbesues për zhvillimin e zgjedhjeve të ndershme.




Kur bëhet fjalë për aktorët përgjegjës për garantimin e zgjedhjeve të ndershme, në një nivel të agreguar shumica e të anketuarve të intervistuar nga Tiranë, Durrës, Lezhë, Berat dhe Korçë besojnë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Qeveria (të dyja me nga 60%) janë aktorët që luajnë një rol shumë të rëndësishëm, të ndjekur nga qytetarët me gjysmën e të anketuarve (49%) që raportojnë rolin e tyre shumë të rëndësishëm. Është e rëndësishme të theksohet, se bashkësia ndërkombëtare është konsideruar si aktori më pak i rëndësishëm në garantimin e zgjedhjeve të rregullta (në krahasim me opsionet e tjera), e cilësuar si shumë të rëndësishme vetëm nga 22% e të anketuarve. Ndërsa ky tregues duket i rëndësishëm për një ndryshim të mentalitetit të qytetarëve shqiptarë, që zakonisht e konsideron ndihmën e huaj si të rëndësishme në garantimin e praktikave demokratike në vend, pikëpamjet e qytetarëve mbi rolin e shoqërisë civile vazhdojnë të jenë jo pozitive. Shoqëria civile është klasifikuar e parafundit në aspektin e rëndësisë me vetëm 28% e të anketuarve që e cilësojnë atë si shumë të rëndësishme. Në të njëjtën kohë, shoqëria civile cilësohet si “aspak e rëndësishme”, me 15%.




Legjitimiteti i zgjedhjeve ka qenë gjithnjë problematik në Shqipërinë post-komuniste² dhe “Zgjedhjet e lira dhe të ndershme” ka qenë një çështje, që ka shoqëruar çdo periudhë para dhe pas-zgjedhore në Shqipëri duke dominuar ligjërimin publik. Të pyetur nëse ata besojnë që zgjedhjet e ardhshme do të jenë të lira dhe të drejta, opinionet e qytetarëve ndryshonin nga njëri qytet në tjetrin.

Kështu, të anketuarit më optimiste ishin në Korçë (me 55% e tyre që mendojnë se zgjedhjet do të jenë e lira dhe të ndershme) dhe Berat (me 52% e të anketuarve që mendojnë të njëjtën gjë). Më pak të anketuar mendonin kështu në Peshkopi (46%), Tiranë (43%), Durrës (40%) dhe Lezhë (36%), edhe pse ata ende përbënin një shumicë në krahasim me pjesën e qytetarëve të cilët nuk mendonin se zgjedhjet do të ishin të lira dhe të ndershme. Të anketuarit në Pogradec ishin më pesimistët me 44% që mendonin se zgjedhjet nuk do të jenë të lira dhe të ndershme. Është interesante të vërehet se 39% e të anketuarve në Lezhë nuk shprehën një opinion mbi këtë çështje.




2 - Pas zgjedhjeve parlamentare të 2013, për herë të parë opozita pranoi rezultatin e zgjedhjeve.


Për sa i përket çështjes se si qytetarët vendosin për të zgjedhur një kandidat të caktuar dhe se ku e bazojnë ata këtë vendim, arsyet variojnë midis cilësive personale, përkatësive partiake dhe programit të kandidatit. Në Berat shumica e të anketuarve (52%) u përgjigjën se vendimi i tyre është bazuar në cilësitë specifike të kandidatit, ndërsa e njëjta arsye ishte vendimtare për gjysmën e të anketuarve në Peshkopi dhe pothuajse gjysmën e të anketuarve në Durrës (47%). Të anketuarit në Tiranë, Lezhë, Korçë dhe Pogradec ishin më të balancuar midis të tri arsyeve të parashtruara me përqindje të përafërta duke përzgjedhur në mënyrë thuajse të barabartë secilën prej tyre. Vetëm në Tiranë, pjesa e qytetarëve që përzgjedh programin e kandidatit si një arsye vendimtare (35%) ishte më e madhe se pjesa e të anketuarve që indikojnë ose cilësitë personale (33%) ose përkatësinë partiake të kandidatit (30%).



Duke ardhur tek njohuritë e qytetarëve mbi përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar komune është menjëherë e qartë se ata e shohin partinë si entitete shumë të centralizuara. Kështu, në përgjithësi, më shumë se 70% e të anketuarve të intervistuar mendojnë se lideri i partisë apo kryesia qendrore e partisë zgjedh kandidatët për kryetar bashkie. Në Lezhë (64%), Berat (53%) dhe në Tiranë (52%) shumica e të anketuarve mendojnë se lideri i partisë është ai që ka përzgjedhur kandidatët, ndërsa në Korçë dhe Pogradec pjesa më e madhe e të anketuarve (44% dhe 37% respektivisht) mendojnë të njëjtën gjë. Në Durrës, 1 në 2 të anketuar mendojnë se kryesia e partisë është struktura që përzgjedh kandidatët për kryetar. Ndërsa pjesa më e madhe e të anketuarve që shprehën një opinion mbi çështjen në Peshkopi (26%) mendon se lideri i partisë është personi që përzgjedh kandidatët për kryetar bashkie. Shumica e të anketuarve në Peshkopi (56%) nuk kanë një përgjigje për këtë pyetje.




Është i dukshëm pështjellimi në përgjigjet e të anketuarve, kur është fjala për subjektin që zgjedh kandidatët për këshillat bashkiakë. Në përgjithësi, në qoftë se hedhim një vështrim tek grafiku i mëposhtëm, është e qartë se të anketuarit janë më të prirur për të parë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për këshillin bashkiak, si më të decentralizuar në krahasim me atë për përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar komune. Kështu, në Korçë dhe në Durrës më shumë se gjysma e të anketuarve, 62% dhe 56% përkatësisht, mendojnë se lideri lokal i partisë, kryesia lokale të partisë apo anëtarësia lokale e partisë janë strukturat përgjegjëse që përzgjedhin këta kandidatë. Berati është i vetmi qytet në shtatë të tillë, ku 1 në 2 të anketuar mendojnë se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për këshillin bashkiak është i bazuar gjithashtu në qendër të partisë me udhëheqësin apo kryesinë qendrore të partisë si aktorët përgjegjës. Përsëri, shumica e të anketuarve në Peshkopi (54%) nuk kanë një përgjigje për këtë pyetje.




Informacioni dhe perceptimi rreth reformës së fundit administrative.


Në zgjedhjet e ardhshme, qytetarët shqiptarë do të votojnë për të zgjedhur 61 kryetarë bashkie krahasuar me 347 që ishin në zgjedhjet e mëparshme dhe kjo për shkak të reformës administrative territoriale që kaloi në korrik të 2014-ës. Riorganizimi drastik i hartës administrative të Shqipërisë e bën reformën vendimtare për këto zgjedhje, ndërsa konfuzioni për procesin shtohet, qytetarët nuk janë të mirë informuar për ndryshimet e fundit administrative në bashkimin e bashkive të tyre. Të pyetur nëse ata ndihen të mirë informuar rreth reformës së fundit administrative, afërsisht 1 nga 4 të anketuar u përgjigjën se janë të mirë informuar. Ndërsa 1 në 2 ishin pjesërisht të informuar. Përveç Beratit e Tiranës shumica e të anketuarve në qytetet e tjera ndjeheshin pak të informuar ose aspak të informuar rreth reformës së fundit administrative. Të anketuarit në Peshkopi ishin ata që ndjeheshin më pak të informuar me 61% prej tyre që ndjeheshin të pa informuar ose pak të informuar, të ndjekur nga të anketuarit në Lezhë dhe Pogradec ku respektivisht 57% dhe 56% e të anketuarve u përgjigjën njësoj.



Të pyetur rreth domosdoshmërisë së reformës administrative, opinionet varionin midis qyteteve, ku në Korçë ishte mbështetja më e madhe me 55 % të të anketuarve të cilët mendonin se reforma ishte shumë e nevojshme dhe 29 % mendonin se reforma ishte pjesërisht e nevojshme. Në ekstremin tjetër ishte Peshkopia, vetëm me 17 % e të anketuarve që mendonin se reforma ishte vërtet e nevojshme dhe 28 % prej tyre e mendonin disi të nevojshme. Në mes janë, Pogradeci, Tirana, Durrësi, Lezha, Berati ku ndarja e madhe përmes reformës për të anketuarit ishte disi e nevojshme. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve në çdo qytet nuk dinte ose nuk donte të jepte një përgjigje për këtë pyetje dhe rreth 2 deri në 5 të anketuar në Peshkopi dhe 1 deri në 4 të anketuar në Berat e bënë një gjë të tillë.




Përveç pyetjes së matjes së perceptimit të domosdoshmërisë, të anketuarit u pyetën nëse ata ishin të kënaqur me reformën e fundit administrative. Në këtë rast të anketuarit në Korçë dhe në Durrës ishin më të kënaqurit me përkatësisht 29% dhe 26 % të të anketuarve të cilët ishin shumë të kënaqur dhe 45 % e 46 % pjesërisht të kënaqur. Në ekstremin tjetër ishte Peshkopia ku 15 % e të anketuarve u përgjigjën se ishin shumë të kënaqur me reformën dhe 28 % u përgjigjën se ishin pjesërisht të kënaqur. Një pjesë e gjerë e të anketuarve në Peshkopi 39 % zgjedhën të mos japin asnjë përgjigje. Niveli i kënaqësisë me reformën në Tiranë, Pogradec, Lezhë dhe Berat ishte në mes të këtyre vlerave. Vlen të theksohet se në çdo qytet pjesa më e madhe e përgjigjeve ishte “po, pjesërisht të kënaqur”.



Në kushtet e informacionit rreth ndryshimeve që reforma administrative do të sjellë në njësitë bashkiake, jo të gjithë qytetarët duken të informuar. Ndërsa të gjitha njësitë bashkiake, ku ne kryem intervistat mbi reformën e fundit administrative të zgjeruar, më të informuarit për këtë ishin të anketuarit në Lezhë (53%), Durrës (48%) dhe Korçë (48%) me afërsisht 1 në 2 të anketuar që treguan se njësia e tyre (komuna) do të zgjerohej. Në anën tjetër, të anketuarit në Tiranë, Peshkopi dhe Pogradec duken më pak të informuar me përkatësisht 23%, 34% dhe 35% e të anketuarve që treguan se njësiti e tyre do të bëheshin më të mëdha. Një pjesë e


konsiderueshme e të anketuarve nuk ishte në gjendje apo zgjodhi të mos jepte një përgjigje për këtë pyetje.

Ekziston edhe një mundësi në fakt, që disa prej të anketuarve të intervistuar në këto qytete të ketë ardhur nga zonat përreth qyteteve apo fshatrave, përreth të cilave ishin dikur komunat e vogla të cilat aktualisht janë duke u përfshirë në këto qytete nga reforma administrative. Në këtë rast kanë kuptim përgjigjet e dhëna nga disa të anketuar të cilët janë përgjigjur se njësitë e tyre (njësitë ku ata janë të regjistruar si banorë dhe ku ata votojnë) do të hiqen.



Qeveria lokale dhe shërbimet publike


Në pesë qytetet ku u kryen intervistat, të anketuarit dukeshin më shumë të pakënaqur sesa të kënaqur me punën e qeverive të tyre vendore gjatë katër viteve të fundit. Nëse shumica e të anketuarve në çdo qytet tregoi se ata ishin pjesërisht të kënaqur me punën e pushtetit lokal në katër vitet e fundit, ishte një pjesë e madhe ajo e atyre të pakënaqur në krahasim me pjesën që tregonte se ishin shumë të lumtur. Nga grafiku i mëposhtëm mund të vërehet dukshëm se vetëm 1% e të anketuarve në Korçë u përgjigjën se ata ishin shumë të kënaqur me punën e pushtetit lokal në katër vitet e fundit, ndërsa një pjesë e madhe me 62% u përgjigjën se nuk ishin të lumtur me punën e qeverisë së tyre vendore në Peshkopi.




Të pyetur për marrëdhëniet e pushtetit qendror me pushtetin vendor, në përgjithësi të anketuarit mendonin se kjo marrëdhënie ishte më e mirë kur kryetari lokal përfaqësonte të njëjtën parti si shumica udhëheqëse (të paktën që nga viti 2013) - në këtë rast Partinë Socialiste apo partitë e tjera të koalicionit të saj. Megjithatë, ky model nuk ishte gjithmonë i dukshëm, siç ishte i qartë në rastin e Pogradecit ku kryetari i mëparshëm, Artan Shkëmbi ishte i Partisë Socialiste, por 30% e të anketuarve raportuan një marrëdhënie të keqe midis pushtetit lokal dhe atij qendror.

Në Tiranë, Peshkopi dhe Lezhë, ku kryetarët e bashkive gjatë këtyre katër viteve të fundit kanë përfaqësuar Partinë Demokratike, të anketuarit perceptojnë se marrëdhëniet e qeverisë qendrore me atë vendore nuk kanë qenë aq të mira sa në rastin e të anketuarve në Durrës, Berat dhe Korçë. Kështu, në Tiranë, ku gjatë katër viteve të fundit kryetari i bashkisë, Lulzim Basha, ishte lideri i opozitës, vetëm 25% e të anketuarve mendonin se marrëdhëniet e qeverisë qendrore me atë lokale ishin të mira ose shumë të mira, ndërsa 46% mendonin se kjo


marrëdhënie ka qenë e keqe ose shumë e keqe. Në Berat, Korçë dhe Durrës kjo marrëdhënie është perceptuar si mjaft pozitive nga shumica e të intervistuarve të këtyre qyteteve – me përkatësisht 57%, 56% dhe 52% të të anketuarve – të cilët e mendojnë marrëdhënien e pushtetit qendror me atë vendor të mirë ose shumë të mirë.




Rreth 1 në 2 të anketuar në qytetet ku kemi intervistuar kanë pasur të bëjnë personalisht me bashkitë e tyre, duke kërkuar ndihmë ose mbështetje nëpërmjet një shërbimi të caktuar. Përfundimisht në Peshkopinë, ku vetëm 17% e të anketuarve kanë raportuar se kanë marrë shërbime nga bashkia. Më shumë se 50% e të anketuarve në Korçë (56%) dhe në Durrës (54%) raportuan raste ku ata kanë pasur të bëjnë vetë me bashkinë.




Të anketuarit që ju përgjigjën po pyetjes së mësipërme u pyetën më pas nëse ata kishin qenë të kënaqur ose të lumtur me zgjidhjen e dhënë nga bashkia. Të anketuarit më pak të kënaqur ishin në Pogradec, Peshkopi dhe Durrës, përkatësisht 60%, 56% dhe 50% e të anketuarve që raportuan se ata nuk ishin të kënaqur me ndihmën e dhënë nga bashkia. Të anketuarit më të kënaqur ishin në Berat dhe Lezhë me 1 në 2 të anketuar të cilët u përgjigjën se ata ishin të kënaqur me ndihmën e ofruar nga bashkia.




Për sa i përket kënaqësisë së përgjithshme në lidhje me shërbimet publike të ofruara nga bashkitë, të anketuarit në përgjithësi ishin pjesërisht të kënaqur, me një shumicë të atyre të pakënaqur se sa atyre të kënaqur. Të anketuarit më të kënaqur ishin të arsimuar, 37% prej të cilëve u përgjigjën te kënaqur ose shumë të kënaqur. Më pak të kënaqur, të anketuarit ishin me planifikimin urban dhe ndërtimet, strehimin, si dhe shërbimet sociale, ku përkatësisht 59%, 56% dhe 50% e të anketuarve treguan se ishin jo të kënaqur ose shumë të pakënaqur.




Lidhur me shqetësimet kryesore të të anketuarve në komunitetet e tyre përkatëse, shqetësimet më të mëdha janë papunësia, varfëria dhe korrupsioni. Papunësia u tregua nga 82% e të anketuarve si një shqetësim i madh dhe vetëm 9% e treguan atë thjesht si një shqetësim, pra më shumë se 9 në 10 të anketuar e konsiderojnë atë një problem në komunitetin e tyre. Varfëria u tregua si një shqetësim i madh nga 71% e të anketuarve dhe thjesht si një shqetësim nga 17% e tyre, pra për pothuajse 9 nga 10 njerëz varfërinë e konsiderojnë si një problem. Korrupsioni u tregua si një shqetësim i madh nga 65% e të anketuarve dhe si një shqetësim nga 16% prej tyre, pra 8 nga 10 njerëz e konsiderojnë atë një problem në komunitetin e tyre. Çështjet që shqetësonin më pak ishin ato në lidhje me sigurinë dhe dhunën në lagje, ndërtimet e paligjshme dhe arsimin. Vlen të theksohet se 1 në 5 të anketuar mendonin se dhuna në lagje dhe siguria ishin shqetësime minimale.




Të anketuarit më pas u pyetën në lidhje me kënaqësinë e tyre kundrejt shërbimeve të veçanta publike të bashkisë. Lidhur me kushtet e çerdheve dhe kopshteve, opinioni i të anketuarve varion në qytete të ndryshme. Kështu, të anketuarit në Peshkopi ishin më të kënaqurit me 86% prej tyre që raportojë të jenë ose shumë të kënaqur ose deri diku të kënaqur me kushtet, e ndjekur nga Korça me 71% e të anketuarve të cilët ishin ose deri diku të kënaqur ose shumë të kënaqur me kushtet. Në Durrës, Pogradec, Lezhë dhe Tiranë shumica e të anketuarve - 59%, 56%, 54% dhe 52% respektivisht - gjithashtu kanë raportuar se ishin disi të kënaqur ose shumë të kënaqur me kushtet e çerdheve dhe kopshteve. Në Berat, të anketuarit ishin më pak të kënaqurit me kushtet, me 44% prej tyre që treguan se ishin deri diku të kënaqur ose shumë të kënaqur.




Lidhur me kushtet e shkollave, të anketuarit në Peshkopi dhe Korçë ishin përsëri më të kënaqurit me 84% e të intervistuarve në secilën bashki të cilët ishin ose disi të kënaqur ose shumë të kënaqur. Niveli i kënaqësisë në qytete të tjera ndryshon nga 67% të kënaqur në Berat dhe Durrës, në 63% në Lezhë, 58% në Pogradec dhe 54% në Tiranë. Pavarësisht niveleve të ndryshme, vlen të theksohet se shumica e të anketuarve në çdo qytet ose ishin deri diku të kënaqur ose shumë të kënaqur me kushtet e shkollave në bashkitë e tyre.



Në lidhje me aktivitetet kulturore dhe turistike të secilës bashki, të anketuarit ishin më të pakënaqur sesa të kënaqur. Kështu, shumica e të anketuarve në Peshkopi (76%), në Pogradec (67%), në Tiranë (64%), në Berat (59%), në Lezhë (59%) dhe në Korçë (52%) ishin ose pak kënaqur ose aspak të kënaqur me këto aktivitete. Vetëm Durrësi paraqet një rezultat disi më të mirë me 48% të të anketuarve që thanë se ishin deri diku të kënaqur ose shumë të kënaqur me aktivitetet kulturore apo turistike në bashkinë e tyre.



Shumica e qytetarëve të intervistuar mendojnë se nuk është bërë sa duhet për zhvillimin ekonomik në bashkinë e tyre. Kështu, një pjesë e madhe e qytetarëve në Pogradec (82%) mendojnë se nuk është bërë sa duhet në bashkinë e tyre për zhvillimin ekonomik, e ndjekur nga Durrësi dhe Lezha me 73% secili dhe Tirana me 71%. Një pasqyrim më i mirë, edhe pse ende negativ, u raportua në Berat dhe Korçë, ku përkatësisht 17% dhe 19% e të intervistuarve thanë se është bërë mjaftueshëm në bashkinë e tyre për zhvillimin ekonomik, ndërsa përkatësisht 61% dhe 54% mendonin se e vërteta ishte e kundërta. Përqindja e atyre që nuk dinin të përgjigjeshin ose nuk zgjodhën të përgjigjeshin ishte gjithashtu e lartë në dy qytete, Peshkopi (30%) dhe Korçë (28%).



Një pakënaqësi e ngjashme është e pranishme kur bëhet fjalë për përpjekjet e bashkisë për të mbrojtur mjedisin. Kështu, pjesa më e madhe e të anketuarve në të gjitha qytetet ku u zhvilluan intervistat u përgjigjën se nuk është bërë sa duhet për mbrojtjen e mjedisit. Ashtu sikurse ndodhi me opinionet rreth zhvillimit ekonomik, në Peshkopi (86%), Lezhë (80%), Durrës (77%), Tiranë (75%) dhe Pogradec (71%) pjesa më e madhe e të anketuarve thanë se nuk është bërë mjaftueshëm për mbrojtjen e mjedisit në bashkinë e tyre. Ky mendim ishte veçanërisht mbizotërues në Peshkopi dhe Lezhë ku më shumë se 8 nga 10 të anketuar shprehën këtë opinion. Përsëri të anketuarit në Berat dhe Korçë ishin më pozitiv për çështjen në krahasim me qytetet e tjera, ku përafërsisht 1 në 4 të anketuar mendonin se është bërë sa duhet për mbrojtjen e mjedisit në bashkinë e tyre, edhe pse përqindja e të intervistuarve të pakënaqur ende përfaqëson shumicën.

